



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr.  
Nr. Dok.202003366/8

Prot.

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave për respektimin e garancive të procesit të rregullt ligjor*

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR  
Tiranë**

**KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË  
Tiranë**

**GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
Tiranë**

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
Tiranë**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje, në një pozicion dinamik proaktiv, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues të gjitha rastet problematike që lidhen me ushtrimin dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të komuniteteve të gjera dhe jo vetëm. Rast i tillë ka qenë edhe situata e krijuar pas vrasjes së të riut Klodian Rasha nga një punonjës i Policisë së Shtetit në datë 8 dhjetor 2020.

Institucioni i Avokatit të Popullit, sikurse ka vepruar dhe vepron në të gjitha rastet e ngjashme ka qenë në vijimësi i pranishëm me grupet përkatëse të inspektimit, në cilësinë e ekipeve faktmbledhëse, për të vëzhguar dhe vlerësuar situatën e krijuar, pas protestave të qytetarëve, të cilat përfunduan në disa raste faktikisht në përplasje të dhunshme.

Në këto rrethana, kemi nisur ndjekjen e çështjeve me iniciativë, në përputhje me nenin 13, paragrafi i tretë, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Kështu, është zhvilluar një hetim i thelluar administrativ pas protestave, në kuadër të respektimit të të drejtave të qytetarëve nga strukturat e Policisë së Shtetit, organi i akuzës dhe gjykatat gjatë shoqërimit, ndalim/arrestimit dhe seancave të vlerësimit të masave të sigurisë. Për faktet dhe shkeljet e konstatuara janë adresuar edhe rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente shtetërore<sup>1</sup>.

Avokati i Popullit gjen rastin të sjellë në vëmendjen e organeve shtetërore e ligjzbatuese, por edhe të publikut të gjerë se, sipas nenit 2 të ligjit 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, është institucion i pavarur kushtetues, nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Avokati i Popullit gjithashtu, është autoriteti kryesor publik që ofron mbështetje për personat e ndaluar ose të arrestuar.

Nga konstatimet e grupeve të ekspertëve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë inspektimeve/verifikimeve pas protestave, në ambientet e strukturave të Policisë së Shtetit, rezulton se u shoqëruan dhe ndaluan një numër i konsiderueshëm protestuesish, ndër të cilët i lartë ishte numri i të miturve. Gjatë përplasjeve fizike me policinë e shtetit, pati të lënduar si nga protestuesit, ashtu edhe nga punonjësit e policisë.

Një pjesë e protestuesve u proceduan nga organi i akuzës dhe dolën përpara gjykatës për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masave të sigurisë.

Kështu, nëse do t'i referohemi deklaratës së dhënë në Kuvendin e Shqipërisë nga Ministri i Brendshëm, z.Bledi Çuçi në datë 01.03.2021<sup>2</sup>, rezulton se: *“Për procedime penale për tubim të paligjshëm janë 578 persona, 97 të arrestuar në flagrancë, nga të cilët të mitur të moshës 14-18 vjeç, 4 persona. Gjithashtu janë proceduar në gjendje të lirë 470 persona dhe janë në kërkim 8 persona. Nga mosha 14-17 janë 215 persona të proceduar, nga 18-29 vjeç janë 276 persona, nga mosha 30-44 vjeç janë 37 persona dhe nga 44-59 vjeç janë 20 persona dhe mbi 60 vjeç janë 5 persona”*.

Në media, u transmetuan kronika të ndryshme ku avokatë dhe familjarë ngritën shqetësime për moslejimin e avokatëve, si dhe caktimin e masës arrest në burg nga gjykata për personat nën hetim deri në sigurimin e provave nga prokuroria etj.

Në vlerësimin tonë spektri i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë plotësohet nga deklarimi konstitucional që askush nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit dhe që gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale kundër tij.

---

<sup>1</sup> Për më tepër, rekomandimet e plota drejtuar Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.

<sup>2</sup>Shih linkun:

[www.ata.gov.al/2021/03/01/protestat-e-dhunshme-pas-vrasjes-se-klodian-rashes-cuci-578-persona-te-proceduar-penalisht-46-police-te-demtuar/](http://www.ata.gov.al/2021/03/01/protestat-e-dhunshme-pas-vrasjes-se-klodian-rashes-cuci-578-persona-te-proceduar-penalisht-46-police-te-demtuar/)

## **Hetimi administrativ**

Nisur nga sa u transmetua në media, institucioni ynë regjistroi rastin me iniciativë dhe filloi hetimin administrativ.

Fillimisht u kërkua informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe më pas në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë** iu parashtruan çështje lidhur me shqetësimet e ngritura në protesta, konkretisht: lidhur me numrin e protestuesve të proceduar dhe veprat penale të parashikuara; garantimin e të drejtës për t'u përfaqësuar me avokat; numrin e personave për të cilët është kërkuar masa e arrestit në burg nga prokuroria; provat mbi të cilat është kryer arrestimi; nëse janë paraqitur pretendime nga personat e proceduar për ushtrim dhune psikologjike/fizike nga punonjësit e policisë gjatë protestës apo më pas gjatë marrjes në pyetje.

Ndërsa, **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** i janë adresuar çështje si: respektimi i masave kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë seancave të zhvilluara në përputhje me parashikimet e udhëzimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.146, datë 27.04.2020 "*Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata*"; respektimi i të drejtës për t'u përfaqësuar me avokat të personave të arrestuar; vlerësimi nga gjykata i arrestimeve në flagrancë të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit etj.

Evidentojmë faktin se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kthyer përgjigje lidhur me çështjet e ngritura nga institucioni i Avokatit të Popullit, edhe pas riadresimit të kërkesës. Përgjigje ka ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas Gjykata e Apelit Tiranë.

Nga verifikimet e kryera në terren gjatë dhe pas protestave nga ekspertët e institucionit, ka rezultuar:

- Është shoqëruar një numër i lartë i të miturve;
- Nuk janë lajmëruar prindërit për disa prej tyre;
- Për të asistuar gjatë pyetjes është thirrur psikologjia e drejtorisë, e cila njëkohësisht e ka pasur të pamundur të jetë prezente në të gjitha komisariatet e Tiranës, por në rekomandimet e tij Avokati i Popullit ka theksuar rëndësinë e thirrjes së një psikologu nga jashtë institucionit, pasi vetëm kështu garantohet paanshmëria dhe objektiviteti;
- Thirrja dhe caktimi i avokatëve kryesisht nga punonjësit e Policisë së Shtetit, shpeshherë sipas pretendimeve të personave, duke mos u lënë mundësinë të marrin avokat nga jashtë, për shkak edhe të mosnjohimit të familjarëve, nuk garanton gjithmonë mbrojtje objektive, efektive dhe të paanshme;
- Nga regjistri i evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar, në shumë raste ka rezultuar se arsyeja e rshoqërimit ishte: "*dyshuar për tubim të paligjshëm*". Rubrika e njoftimit të familjarëve paraqiste problematika, sepse më shumë përmbante shënimin "*refuzon të njoftojë, ose do të njoftojë në një moment të dytë*".

- Ka pasur pretendime për ushtrim dhune, për të cilat kanë vijuar hetimet nga institucioni.<sup>3</sup>

Në përgjigje të kërkesës tonë nr.K2/I90-2 prot., datë 05.01.2021, me shkresën nr.53/1, datë 19.01.2021, na janë përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kopje të njësuara me origjinalin të vendimeve gjyqësore për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masave të sigurimit personal për protestuesit.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se janë dhënë 6 vendime nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vendimin nr.2047, datë 14.12.2020 konstatohet se veprat për të cilat dyshohen personat nën hetim janë renditur **në bllok (en bloc) për të 35 protestuesit pa përjashtim, të akuzuar në grup për 7 vepra penale**: “Prishje e rendit dhe qetësisë publike”; “Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”; “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”; “Organizimi dhe pjesëmarrje në grumbullime e manifestime të paligjshme”: “Shkatërrim prone me zjarr”: “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”; “Pengim i qarkullimit të transportit rrugor”, parashikuar nga nenet 274, 242, 236, 262, 151, 278/3 dhe 293 të Kodit Penal.

Nga organi i prokurorisë për 24 persona në hetim është kërkuar caktimi i masës “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për një shtetas masë “arrest në burg me afat 40 ditë”, ndërsa për 10 shtetas të tjerë masë “arrest në shtëpi”.

Si prova kryesore të paraqitura në gjykatë nga organi i prokurorisë, mbi bazë të të cilave është kërkuar vleftësimi i arrestimeve në flagrancë dhe caktimi i masave të sigurimit personal, janë raportet e shërbimit të përpiluara nga punonjësit e policisë dhe/ose procesverbalet e kapjes në flagrancë. Gjithashtu prokuroria parashtron se policia referon se për këtë tubim nuk është dhënë njoftim nga ndokush në organet policore. Kështu, përfaqësuesi i prokurorisë i referohet policisë për kryerjen e hetimeve shtesë, administrimin e pamjeve filmike nga kamera të ndryshme publike e të sipërmarrjeve të ndryshme në vijim.

Gjykata ka arritur në përfundimin se ekziston një dyshim i arsyeshëm se personat nën hetim kanë konsumuar veprat penale për të cilat dyshohen, 7 vepra penale në bllok të lartpërmendura.

Kështu, janë vleftësuar nga ana e organit të gjykatës si të ligjshëm arrestimet në flagrancë për të 35 personat nën hetim, duke caktuar masën e “arrestit në burg me afat 15 ditë” për një shtetas, masën “arrest në shtëpi” për 10 të tjerë si dhe masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për 24 shtetas të tjerë.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur gjykata edhe në vendimin nr.2049 akti, datë 14.12.2020, ku janë vleftësuar arrestimet për 8 persona në hetim, të dyshuar **për kryerjen e 6 veprave penale në bllok**. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar masat e sigurimit personal sipas kërkesës së paraqitur nga prokuroria, konkretisht: për 4

<sup>3</sup> Në lidhje me këto raste kanë dalë rekomandimet përkatëse drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit apo dhe ka vijuar hetimi administrativ nga institucioni i Avokatit të Popullit.

shtetas masën “arrest në burg me afat 10 ditë”; për 2 shtetas masën “arrest në shtëpi” dhe masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për 2 shtetas të tjerë.

Ndërsa, në vendimin nr.2048 Akti, datë 13.12.2020 konstatohet se personat janë dyshuar për kryerjen e disa veprave penale, që variojnë nga 3 deri në 5 të tilla konkretisht për: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “Prishja e qetësisë publike”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë të rendit publik”; “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, “Shkatërrimi i pronës”; “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, të parashikuara nga nenet 262, 274, 236/2, 279/2 dhe 150 i Kodit Penal.

Përfaqësuesja e prokurorisë ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm të arrestimeve në flagrancë, për dy shtetas ka kërkuar caktimin e masës “arrest në burg”, për 6 të tjerë masën e “arrestit në shtëpi” dhe për 3 shtetas masën “detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Prokuroria ka paraqitur si prova shkresore para gjykatës në tërësi aktet procedurale të ndodhura në fashikullin e procedimit penal nr.8832 të vitit 2020.

Sa i përket, qëndrimit të gjykatës në lidhje me vlerësimin e masës së sigurimit dhe kushtet për caktimin e saj, Gjykata e Lartë është shprehur si më poshtë:

*“Gjykata, çmon lidhur me provat se që të ndërmerret kryesisht veprimi procedural i arrestimit për kryerjen e një veprë penale, përse i përket dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova duhet të plotësohen dy kushte:*

- i) ekzistenca e veprës penale me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e faktit kriminal pa të cilin, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi dhe:*
- ii) dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se fakti penal kriminal është kryer prej të dyshuarit për të cilin kërkohet caktimi i masës së sigurimit dhe jo nga ndonjë person tjetër. Gjykata konstaton se në këtë fazë të hetimit s’ka asnjë provë direkte apo indirekte që të provojë se personat nën hetim i kanë konsumuar këto vepra penale.”<sup>4</sup>*

Pas një analize të hollësishme, ku janë trajtuar të drejtat e njeriut, në mënyrë të veçantë e drejta e tubimit, parimet e KEDNJ-së, Kushtetutës, çështjet e trajtuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në përfundim, gjykata ka vleftësuar arrestimet në flagrancë dhe ka dhënë për dy shtetas masën e “arrestit në burg” dhe për shtetasit e tjerë masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Një tjetër vendim i administruar nga ana jonë është ai me nr.2057 Akti, datë 14.12.2020 ku konstatohet se janë 7 persona nën hetim, për të cilët prokuroria kërkon vleftësimin si të ligjshëm të “arrestit në flagrancë”, të gjithë shtetasit janë të akuzuar për 3 vepra penale **“të njëjta” për të gjithë:** “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”, të parashikuara nga nenet 262, 236/2 dhe 293 të Kodit Penal.

---

<sup>4</sup> Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.141 i Regj.Themeltar, nr.112 vendimi, datë 26.09.2005 faqe 3.

Provat mbi të cilat organi i akuzës mbështet kërkesat e tij janë **raportet e shërbimit dhe/ose procesverbalet e kapjes në flagrancë të shtetasve**. Përfaqësuesi i prokurorisë ka kërkuar masën “arrest në shtëpi” për 6 shtetas dhe masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për një shtetas.

Gjykata ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe ka caktuar masën e **“arrestit në burg” për 6 personat nën hetim për t’i dhënë kohë akuzës, për të kryer disa veprime hetimore si janë:**

- administrimi i CD-së me pamje filmike nga kamerat e sigurisë;
- administrimi i tabelave fotografike;
- pyetja me cilësinë e deklaruësve; të punonjësve të policisë që kanë hartuar raportin e shërbimit, duke u përcaktuar nga ana e tyre saktë dhe qartë veprimet e kryera nga ana e personit nën hetim.

Në përfundim të gjykimit është vendosur për 6 shtetas masa “arrest në burg me afat 10 ditë (deri në datë 24.12.2020)” dhe për një shtetas masa “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Gjithashtu, po e njëjta gjyqtare me vendimin nr.2058, datë 14.12.2020 ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të “arrestimeve në flagrancë” për personat nën hetim dhe ka caktuar për 5 shtetas masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe për 4 të tjerë masën “arrest në shtëpi”, sipas kërkesës së paraqitur nga organi i prokurorisë.

Ndërsa, me vendimin nr.2061, datë 14.12.2020 e njëjta gjyqtare ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të “arrestimeve në flagrancë” për personat nën hetim dhe ka caktuar për 4 shtetas masën “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe për 4 të tjerë masën “arrest në burg”, sipas kërkesës së paraqitur nga organi i akuzës.

Në vijim, për të marrë një informacion shtesë dhe për të krijuar një tablo më të qartë në lidhje me rastin në trajtim, sa i përket qëndrimit të organeve gjyqësore lidhur me vlerësimin e arrestimeve dhe caktimin e masave të sigurimit personal, i jemi drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për informacion lidhur me ankimet ndaj vendimeve të mësipërme.

Në përgjigjen e kthyer me shkresën nr.1805/1 prot., datë 27.04.2021, kjo gjykatë parashtron si më poshtë vijon:

*“Nga Gjykata e Apelit Tiranë janë gjykuar çështje penale dhe në përfundim të gjykimit janë dhënë vendimet gjyqësore penale si më poshtë:*

- *Vendimi penal nr.1131, datë 30.12.2020;*
- *Vendimi penal nr.1124, datë 30.12.2020;*
- *Vendimi penal nr.1125, datë 30.12.2020;*
- *Vendimi penal nr.40, datë 13.01.2020;<sup>5</sup>”*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga kjo gjykatë (fotokopje të vendimeve gjyqësore) konstatohet se:

---

<sup>5</sup> Vendimi nr.21, datë 06.01.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë, që nuk ishte dorëzuar ende në sekretarinë gjyqësore.

Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin nr.40, datë 13.01.2021 ka ndryshuar një masë të sigurimit personal nga “arrest në shtëpi” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, pasi është ushtruar ankim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vetëm nga një shtetas.

*Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit vlerëson “se përse kohë jemi në gjykimin e caktimit të masës së sigurimit provat e marra ndaj personit nën hetim janë në fazën fillestare dhe në këto kushte duhet të marrim parasysh provat që janë në dosje dhe faktin nëse ekziston elementi kriminal pa të cilin nuk mund të diskutohet caktimi i masës së sigurimit.*

***Nga aktet e ndodhura në dosje nuk rezulton se ekzistojnë dhe plotësohen të gjithë elementët e dyshimit të arsyeshëm për personin nën hetim.***

*Lidhur me llojin e masës së sigurimit personal Gjykata e Apelit çmon se masa “arrest në shtëpi”, e caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk i përshtatet shkallës së nevojave të sigurimit në rastin konkret. Një masë e tillë, në respektim të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, nuk i përgjigjet rrezikshmërisë shoqërore të personit. Nga provat e paraqitura në gjykim, nuk rezulton e provuar se ekziston rreziku i largimit të të dyshuarit, shmangies së tij ndaj hetimeve, rreziku i marrjes së provave, apo rreziku që ky person të kryejë një vepër tjetër të rëndë apo më të rëndë. Personi nën hetim rezulton të jetë i padënuar më parë, rrethana këto që përlligjin caktimin e një mase sigurimi më të butë se ajo e arrestit në shtëpi.*

*Gjykata e Apelit çmon se nga dinamika e faktit që rezulton nga provat e sjella nga organi i akuzës, gjykatës i krijohet bindja se masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nuk është masa më e përshtatshme për momentin në lidhje me këtë rast. Gjykata çmon se në rastin konkret masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” e kërkuar edhe nga mbrojtja e personit nën hetim, është një masë proporcionale dhe e përshtatshme për rrethanat konkrete.”*

Me vendimin nr.1124, datë 30.12.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë është ndryshuar vendimi nr.2061 Akti, datë 14.12.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>6</sup>. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankim 4 shtetas lidhur me caktimin e masave të “arrestit në burg”, duke caktuar për të katër ankuesit masën “arrest në shtëpi”.

Me vendimin nr.1125, datë 30.12.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur miratimi i vendimit penal nr.2057 akti, datë 14.12.2020<sup>7</sup> të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij të fundit është ushtruar ankim nga 2 shtetas. Gjykata ka vleftësuar si të ligjshëm “arrestimet në flagrancë” të personave nën hetim dhe ka vendosur mospranimin e ankimit të ushtruar prej tyre.

Në vendimin nr.1131, datë 30.12.2020 Gjykata e Apelit Tiranë konstaton se vendimi i gjykatës së shkallës së parë<sup>8</sup> është i drejtë përse i përket vleftësimit të ligjshëm të arrestimit në flagrancë, por gjykata çmon se ky vendim duhet të ndryshojë përse i përket

<sup>6</sup> Ky vendim gjyqësor ka caktuar masa të sigurimit personal për 8 shtetas. Ndaj tij është ushtruar ankim nga 4 shtetas, persona në hetim.

<sup>7</sup> Ky vendim gjyqësor ka caktuar masa të sigurimit personal për 7 shtetas. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim vetëm nga 2 shtetas.

<sup>8</sup> Vendim nr.2058 Akti, datë 14.14.2020 ka caktuar masa të sigurimit personal ndaj 9 shtetasve dhe ndaj tij është ushtruar ankim nga 2 shtetas.

caktimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj një personi nën hetim, **pasi nuk janë vlerësuar drejt të gjitha rrethanat e faktit nga gjykata e shkallës së parë**, si dhe nuk janë zbatuar drejt kërkesat e nenit 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale.

## **Kuadri ligjor**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është ligji themelor me përcaktimet e saj përkatësisht në nenet 17, 28 dhe 31<sup>9</sup>.

Kodi i Procedurës Penale parashikon kushtet e përgjithshme që duhet të ekzistojnë në një rast konkret, që gjykata të mund të caktojë një masë të sigurimit personal dhe që nga ana tjetër kufizimi i të drejtave dhe lirive të shtetasve të jetë kushtetutshmërisht i bazuar.

Është detyrë e gjykatës që të vlerësojë kërkesat e organit të prokurorisë për caktimin e masave të sigurimit personal, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat, në favor ose kundër interesit publik, që për ligj një përjashtim nga parimi i respektimit të lirive të individit, duke pasur parasysh prezumimin e pafajësisë dhe paraqitjen e tij në argumentimin e vendimit të dhënë<sup>10</sup>.

Më konkretisht, në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masës së sigurimit, si më poshtë vijon:

- 1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.*
- 2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale, ose dënimit.*
- 3. Masat e sigurimit personal vendosen:*

---

<sup>9</sup> Neni 17 “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 28 “1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij. 2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi “c”, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. 3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundër një garancie pasurore sipas ligjit. 4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase. 5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.”

Neni 31 “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.”

<sup>10</sup> Tomasi kundër Francës, dt. 27.08.1993.



- a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.”

Kushti i parë ka të bëjë me ekzistencën e **dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova**. Kushti i dytë ka të bëjë me ekzistencën e **shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale**, kur nuk mund të zbatohen masat e sigurimit personal. Kurse, kushti i tretë ka të bëjë **me ekzistencën e nevojës së vendosjes së masave të sigurimit personal** (kushtet e veçanta).

Më tej, në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohen kriteret e caktimit të masave të sigurimit:

- “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.
- 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.
- 3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.”

Kriteret e parashikuara në këtë dispozitë ligjore synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret.

Lidhur me caktimin e llojit të masave të sigurimit, sjellim në vëmendje Vendimin Unifikues nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në caktimin e llojit më të përshtatshëm të masave të sigurimit, ku theksohet se:

“Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Si në rastin kur masa e sigurimit caktohet për herë të parë, ashtu edhe kur shqyrtohet zëvendësimi i masës ekzistuese, gjykata nuk ka detyrim të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, **mjafton të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret është masa e përshtatshme.**”

Gjatë gjykimit të kërkesave të paraqitura nga organi i prokurorisë për vendosjen e masave të sigurimit, gjykata që e shqyrton atë ka detyrimin ligjor që, përpos verifikimit të kushteve që kërkohen në caktimin e masës së sigurimit (neni 228 i Kodit të Procedurës Penale), duhet të analizojë e të arsyetojë bazuar në aktet e fashikullit gjyqësor edhe në lidhje me kriteret e përgjithshme e të veçanta që ka parashikuar ligjvënësi përkatësisht në nenet 229 e 230 të Kodit të Procedurës Penale, duke arritur në një konkluzion ligjor rast pas rasti dhe jo duke atribuar në bllok veprat penale për personat nën hetim, apo duke iu atribuar të njëjtat vepra penale një numri të gjerë protestuesish.

Nevoja e sigurimit (rreziku për të kryer sërish të njëjtën vepër penale), rrezikshmëria e veprës dhe autorit të dyshuar në caktimin e llojit të masës së sigurimit personal, mbahen parasysh në çdo rast nga ana e gjykatës.

Gjykata duhet të analizojë me kujdes nëse nga provat e paraqitura në gjykim rezulton e provuar se ekziston rreziku i largimit të të dyshuarit, shmangies së tij ndaj hetimeve, rreziku i marrjes së provave apo rreziku që ky person të kryejë një vepër tjetër të rëndë apo më të rëndë.

Lidhur me dyshimin e arsyeshëm duhen mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga aktet ndërkombëtare dhe legjislati i brendshëm, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 27) dhe neni 5 i Konventës Evropiane të të drejtave të Njeriut. Duke iu referuar praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në interpretim të konceptit dyshim i arsyeshëm, kjo Gjykatë është shprehur se: *“Dyshimi i arsyeshëm parashikon ekzistencën e provave të besueshme, të cilat mund të bindin vëzhguesin e paanshëm se një person i caktuar mund të ketë kryer veprën penale për të cilën dyshohet.”*<sup>11</sup>

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim, objektivisht i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit.

Neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut reflektohet në nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës. Liria e personit nuk mund të kufizohet, veç në rastet e nevojshme, ndër të tjera, kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Po në këtë nen sanksionohen të drejtat dhe garancitë me natyrë procedurale ndaj personit të cilit i hiqet liria, si: e drejta e njoftimit në një gjuhë të kuptueshme të shkaqeve të masës, akuzën që i bëhet, e drejta për të mos bërë deklaratë, e drejta për të komunikuar me avokatin, e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor që kufizon lirinë, e drejta për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm etj.

Neni 232 i Kodit të Procedurës Penale përcakton llojet e masave shtrënguese, ku masa e sigurimit personal e “arrestit në burg” duhet të zbatohet kur aplikimi i masave më të lehta nuk është i justifikuar. Në vijimësi qëndrimi i institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë se vendosja e masës së arrestit në burg duhet të aplikohet si rast përjashtimor dhe si masë e fundit për personat në hetim për kryerje të veprave penale që parashikojnë dënime të rënda.

Duhet të krijohet bindja se provat të bëjnë të dyshosh që është kryer apo është duke u kryer një vepër penale. Natyrisht, kjo bindje apo dyshim i arsyeshëm krijohet kur personi ndalohet, ose arrestohet në flagrancë, por kjo bindje duhet të jetë e atillë që të vlerësohet nga gjyqtari. Në të dyja rastet respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë. Dyshimi i arsyeshëm sipas GJEDNJ kërkon fakte, ose informacione, që do të bindin një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale<sup>12</sup> për të cilën dyshohet. Fakti që një individ ka precedentë penalë nuk konsiderohet i mjaftueshëm për

<sup>11</sup> Shih çështjet *Ciulla kundër Italisë* dhe *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

<sup>12</sup> Çështja *Fax, Campbell dhe Hartley k. Mbretërisë së Bashkuar*.

të krijuar dyshime të arsyeshme. Dyshimi i arsyeshëm mund të bazohet edhe në informacione anonime. Megjithatë, GJEDNJ ka vlerësuar se informacionet e një informatori anonim, të pakonfirmuara nga prova apo informacione të tjera, janë të pamjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm.<sup>13</sup>

Kodi i Procedurës Penale të RSH parashikon vendosjen e disa masave paraprake të kufizimit të lirisë, përkatësisht “*arrestimi në flagrancë*” dhe “*ndalimi i të dyshuarit për një krim*”. Këto masa paraprake kanë kohëzgjatje të kufizuar në kohë dhe duhet të ndjekin respektimin e disa kriterëve strikte, si edhe të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj personave që zbatohen, deri sa gjykata të vendosë vleftësimin ose jo të masës së sigurimit personal të kërkuar nga prokuroria. Ndalimi nuk lidhet me flagrancën, por me dyshimin për kryerjen e një krimi dhe rrezikun e ikjes. ***Kërkesa e prokurorit për vlerësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit, si masë e ligjshme, dhe për caktimin e masës së sigurimit që vlerësohet e përshtatshme, duhet të jetë e argumentuar.***

Kështu, ndër të tjera edhe arrestimi në flagrancë duhet të kryhet nga strukturat e policisë gjyqësore të organit të Prokurorisë dhe nën drejtimin e prokurorit, sipas neneve 24/1, 30/2 dhe 304/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo me qëllim që të mënjanohet çdo situatë konflikti interesi për shkak se strukturat e policisë kanë qënë subjekt i dëmtuar. Avokati i Popullit e gjen me vend të theksojë se, në vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj autorëve të dyshuar të veprave penale duhen mbajtur gjithmonë në konsideratë kushtet dhe kriteret e caktimit të tyre të parashikuara nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 228, 229 dhe 230 të tij.

Gjithashtu, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet, në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet çasti, ora, e kapjes së tij në fakt, kur ai është privuar realisht nga liria. Pra, sapo ai kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrin të ndalimit. Duke iu referuar neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbalin i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48- të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Gjatë trajtimit të këtij rasti, objekt i hetimit tonë administrativ, pas analizimit të dokumenteve të administruara, është evidentuar se për një numër të konsiderueshëm të shtetasve që janë ndaluar/arrestuar në flagrancë, prokuroria ka kërkuar masat “*arrest në burg*” ose “*arrest në shtëpi*”. Po kështu, janë konstatuar, raste të caktimit të masës së sigurimit, pa vlerësuar në kompleks edhe rrethanat, kushtet në të cilat është kryer vepra, pasojat që kanë ndodhur etj. Personave iu janë atribuar disa vepra penale ( 3-7 ), të njëjtat. Në disa raste është zbatuar masa e arrestit në burg edhe kur ndalimi/arrestimi bëhet për vepra që parashikojnë dënime penale të lehta, kur ndërkohë mund të justifikohet edhe një masë më e lehtë. Sipas Kodit të Procedurës Penale çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. *Arrestimi në burg* mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit.

---

<sup>13</sup> *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016, fq 196, paragrafi 49/2

Në shumicën e rasteve të hetuara nga ana jonë, rezultoi se kërkesat për masat e sigurimit bazohen kryesisht në provat e mbledhura nga policia e shtetit dhe se prokuroria nuk ka kryer hetim apo përpunim të akteve të përpiluara nga strukturat e policisë.

Vërehet se provat e siguruara nga prokuroria gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nuk kanë respektuar në mënyrë të plotë kërkesat e ligjshmërisë. Në vlerësimin tonë, organi i prokurorisë duhet të jetë më rigoroz në mbikëqyrjen dhe respektimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale për të gjitha veprimet procedurale që kryhen ndaj personave nën hetim, duke drejtuar dhe kontrolluar hetimet paraprake dhe veprimet hetimore që i çmon të nevojshme.

Ndërgjegjësimi për zbatimin e drejtë të ligjit nga ana e organit të akuzës do të reflektojë edhe në respektimin më të mirë të të drejtave që ligji iu garanton personave të ndaluar/arrestuar dhe atyre ndaj të cilëve caktohet një masë sigurimi personal.

Neni 6<sup>14</sup> i KEDNJ-së garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të hapur në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të një individi ose të ndonjë akuze penale kundër tij. Gjykata, dhe më parë edhe Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut e kanë interpretuar gjerësisht këtë nen, me motivin se është me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë. Në çështjen *Delcourt kundër Belgjikës*, Gjykata deklaroi se: *“Në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës, e drejta për një ushtrim të drejtë të drejtësisë zë një vend kaq të rëndësishëm sa një interpretim i kufizuar i nenit 6 (1) nuk do t’i korrespondonte synimit dhe qëllimit të asaj dispozite.”* Paragrafi i parë i nenit 6 zbatohet si për ndjekjet civile ashtu edhe penale, ndërsa paragrafi i dytë dhe i tretë deklarohen se zbatohen vetëm për ndjekjet penale.

Gjyqtarët të cilët drejtojnë një seancë gjyqësore duhet të sigurojnë që të respektohen të gjitha garancitë që përmban neni 6 i KEDNJ-së. Çdo gjyqtar në fillim të një seance duhet të ketë parasysh përgjegjësinë për të siguruar që këto garanci të respektohen, dhe në përfundim të seancës të kontrollojë nëse ai/ajo e ka kryer detyrën. Veçanërisht në çështjet penale, gjyqtari duhet të sigurojë që i pandehuri është i përfaqësuar në mënyrë e duhur. Ai/ajo ka gjithashtu përgjegjësinë për të marrë masat përkatëse për të përket të pandehurve të pambrojtur. Gjyqtarit mund t’i duhet të refuzojë për të proceduar me gjyqin, nëse ai/ajo mendon se ka nevojë për përfaqësim ligjor, kur nuk është vënë në

---

<sup>14</sup> Neni 6 “E drejta për një proces të rregullt”:

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

dispozicion. Gjyqtari ka përgjegjësinë që të sigurojë që të mbështetet parimi i barazisë në mjete, që do të thotë se të gjitha palëve duhet t'u jepet një mundësi e drejtë për të prezantuar çështjen e tyre në kushte të tilla që të mos vihen në një disavantazh të konsiderueshëm përballë kundërshtarëve të tyre.

Garancitë e parashikuara në nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por gjithashtu edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Në çështjet penale garancitë përfshijnë hetimet paragjyqësore të kryera nga policia.

Gjykata ka kohë që e ka njohur faktin se të drejtat e një procesi të drejtë gjyqësor të pasqyruara në Konventë përsa i përket fëmijëve dhe të rriturve dhe në çështjen *e Nortier kundër Vendeve të Ulta*, Komisioni pati këndvështrimin se çdo sugjerim që fëmijët që akuzohen për shkelje penale të mos përfitojnë nga garancitë e procesit të drejtë, ishte e papranueshme.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, parashikon parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Ky parim, po ashtu përshkon edhe ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë synimi kryesor në çdo vendim që merret mbi jetën e fëmijës si nga institucionet shtetërore apo ato private.

Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim normal fizik dhe moral, si dhe për të gëzuar një jetë familjare dhe sociale të përshtatshme për fëmijën. Interesi më i lartë i fëmijës gjen zbatim në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren nga autoritetet publike dhe jopublike, si dhe nga gjykatat në lidhje me fëmijët.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ka si qëllim:

1. Të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit.
2. Të promovojë riintegrimin e të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm.
3. Të garantojë rishoqërimin dhe rehabilitimin e të miturit që ka kryer veprë penale.
4. Të mbrojë të drejtat e të miturit në rastet kur është dëshmitar dhe/ose viktimë e veprës penale.
5. Të parandalojë riviktimizimin dhe viktimizimin e dytë të të miturit, i cili më parë ka qenë viktimë e një veprë penale.
6. Të parandalojë përsëritjen e veprave penale prej të miturit.
7. Të mbrojë parimet e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur.
8. Të rrisë përgjegjshmërinë dhe profesionale-lizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur.
9. Të garantojë masa edukative dhe parandaluese për të miturit që kryejnë vepra penale dhe të sigurojë ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e tyre."

Sipas nenit 9 të Kodit parashikohet: "1. Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë 2.Çdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij."

Parimi që ofron neni 10, pika 3 për të miturit në konflikt me ligjin duhet të zbatohet nga organet shtetërore gjatë punës së tyre: *“Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.”*

Sipas nenit 14 të këtij Kodi, në procedurën e drejtësisë penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal. Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrajt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget vënia në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij. Çdo masë që përdoret ndaj të miturit si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t'i shërbejë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave dhe garancive ligjore të të miturit.

Kështu, në nenin 15 të Kodit **kufizimi ose heqja e lirisë parashikohet si masë e fundit** përdoren vetëm si një masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër, si dhe janë objekt i rishikimit të rregullt periodik nga gjykata.

Është thelbësore që prokuroria dhe gjykata të zbatojnë dispozitat e neneve 85 dhe 86 për kërkimin/vendosjen e masave të arrestit në burg për të miturit, si më poshtë:

*“1. I mituri mund të arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të këtij Kodi.*

*2. Kur nuk urdhëron lirim të menjëhershëm, prokurori, pa vonesë, por, sidoqoftë brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e tyre në gjykatën kompetente.*

*3. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë dhe i mituri të lirohet menjëherë, përveç kur gjykata i vleftëson ato dhe cakton masë sigurimi.*

*4. Në shqyrtimin për vleftësimin e arrestit ose të ndalimit, gjyqtari dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin menjëherë.”*

*“Përveç parashikimeve të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale, masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston edhe ndonjë nga kriteret e mëposhtme:*

*a) sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet;*

*b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri:*

*i) përmban rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër;*

*ii) përpiqet t'i shmanget drejtësisë.”*

Vlen të theksohet se organet kompetente kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e duhura, për të siguruar që personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitarë. Po ashtu, personat që administrojnë procesin e drejtësisë penale, për të mitur duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Po ashtu, sjellim në vëmendje se sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT) në shumë vende të Evropës, problemi i vazhdueshëm i mbipopullimit në burgje, me të gjitha sfidat e lidhura me të, duhet t'i atribuohet në një masë të madhe përqindjes së lartë të popullimit të burgjeve nga të parburgosurit (të cilët janë personat e ndaluar me urdhër të gjykatës që janë ende në pritje të gjykimit, ose nuk janë dënuar me një vendim të formës së prerë)<sup>15</sup>.

Brenda zonës së Këshillit të Evropës, shpeshësia dhe kohëzgjatja e parburgimit duket se ndryshojnë shumë në praktikë nga një vend në tjetrin, me përqindjen e personave të ndaluar në parburgim në raport me popullatën e përgjithshme të burgjeve që varion nga 8% deri në 70%.<sup>16</sup>

Për shkak të natyrës ndërhyrëse të parburgimit dhe duke pasur parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë, parimi themelor është se parburgimi duhet të përdoret vetëm si masë fundore (*ultima ratio*). Parburgimi **duhet të vendoset për kohën më të shkurtër të mundshme dhe duhet të bazohet në një vlerësim rast pas rasti bazuar në rrezikshmërinë e kryerjes së një krimi të ri, fshehjes ndaj drejtësisë, manipulimit me dëshmi ose dëshmitarë, ose të ndërhyrjes në punën e drejtësisë**. Për më tepër, kur vlerësohet proporcionaliteti i masës duhet të merret parasysh natyra dhe shkalla e veprës penale që dyshohet të jetë kryer nga personi në fjalë.

Sipas këndvështrimit të KPT-së, parimi që ndalimi në parburgim duhet të vendoset vetëm si mjet i fundit nënkupton në radhë të parë që sa më shumë të jetë e mundur duhet të zbatohen masat jo nën ruajtje (pra, jo në parburgim). Kjo kërkon disponueshmërinë e një game të gjerë masash, si pezullimin e kushtëzuar të parburgimit, lirimin me kusht, arrest shtëpie, monitorimin elektronik, detyrimin për të përmbushur urdhrat e caktuara, mbikëqyrjen gjyqësore, marrjen e pasaportave etj.<sup>17</sup>

Vlerësojmë se duhet të ekzistojë një raport i drejtë proporcionaliteti. Kështu, ndalimi i protestuesve nuk mund të jetë masë proporcionale në kushtet kur personat që gjenden jashtë ambienteve të shoqërimit/sigurisë janë shumë më mirë se brenda tyre. Për këtë arsye, numri i lartë i të shoqëruarve dhe ndaluarve bën që shkak i paligjshmërisë së protestës të bjerë.

Për më tepër, dhomat e shoqërimit dhe ato të sigurisë kanë kapacitet për një-dy persona, ndërkohë që në to ishin vendosur mbi 6 persona. Kjo ndër të tjera, në këtë situatë pandemie globale që po kalojmë, përbën edhe shkak për përhapjen e sëmundjes së COVID-19.

Nga vlerësimi i kushteve materiale të dhomave, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimale e

<sup>15</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës (KPT), Pjesë nga raporti i 26-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2017.

<sup>16</sup> Statistikat Vjetore Penale të Këshillit të Evropës, SPACE I – Popullsia në burgje, Anketë 2015, PC-CP (2016) 6, 15 dhjetor 2016, tabelat 4 dhe 5.1. Sipas kësaj ankete, mesatarisht, rreth 25% e të gjithë të burgosurve në zonën e Këshillit të Evropës kanë qenë në parburgim.

<sup>17</sup> Shih nenet 5(1)(c) dhe 5(3) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe Dokumentin e Bardhë për Mbiipopullimin në Burgje, Komiteti i Problemeve të Krimeve të Këshillit të Evropës (CDPC), PC-CP (2015) 6 rish. 7, paragrafi 62.

hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m<sup>2</sup>, për dhomat për një person dhe 4 m<sup>2</sup>, kur në to sistemohen më shumë persona (pa llogaritur objektet sanitare)<sup>18</sup>. Sigurimi i hapësirës jetësore në më pak se 4 m<sup>2</sup> rrit ndjeshëm rrezikun e shkeljes së nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>19</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron këtë si një problematikë të qenësishme, duke pasur parasysh kapacitetet e lejuara për akomodimin e tyre në këto ambiente.

Së fundmi, duke qenë se personave në hetim u është atribuar ndër të tjera vepra penale e “Organizimit dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, do të donim të ceknim lirinë e tubimit, duke sjellë në vëmendjen tuaj vendimin nr.24 datë 04.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Çështjen me kërkuese Gjykatën e Apelit Shkodër, subjekte të interesuara: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; Këshilli i Ministrave dhe Avokati i Popullit, me objekt: “*Shfuqizimi i togfjalëshit “pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta” në paragrafin e parë të nenit 262 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si i papajtueshëm me nenet 17, pika 1 dhe 47 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*”

Avokati i Popullit vlerëson se legjislacioni që mbulon lirinë e tubimit paqësor duhet të jetë i qartë dhe i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sipas këtyre të fundit, nuk është e nevojshme që legjislacioni i brendshëm të kërkojë njoftimin paraprak të një tubimi, por njoftimi u mundëson autoriteteve shtetërore të lehtësojnë mbledhjen e protestuesve, si dhe të sigurojnë rendin publik dhe të mbrojnë të drejtat e të tjerëve.

***Liria e tubimit nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti miratimi nga organet e policisë***, por për ushtrimin e kësaj të drejte, sipas ligjit nr.8773/2001 “Për tubimet”, kërkohet vetëm bërja e njoftimit në organet e policisë në një kohë të përcaktuar. Fakti që në ligjin nr.8773/2001 përdoret termi “njoftim” dhe jo “kërkesë”, drejtuar organeve të policisë për zhvillimin e tubimit është me rëndësi, pasi garanton ushtrimin e së drejtës së tubimit nga ana e shtetasve. Pra, vendimin për ushtrimin e së drejtës së tubimit e merr vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi/leja e organit të policisë.

***Togfjalëshi që përmban neni 262, paragrafi i parë, i KP-së, objekt kërkese, është i papajtueshëm me nenin 47 të Kushtetutës, si dhe me nenet 11 dhe 18 të KEDNJ-së***, pasi kufizon ushtrimin e së drejtës së tubimit me marrjen e lejes, ndërkohë që leja nuk parashikohet as në Kushtetutë, as në ligjin nr. 8773/2001 “Për tubimet”. Ky togfjalësh jo vetëm është i tejkaluar në kohë, pasi i përket periudhës përpara miratimit të Kushtetutës së vitit 1998, por nuk është përshtatur as me ligjin nr. 8773/2001 “Për tubimet”.

Parashikimi në dispozitën ligjore, objekt shqyrtimi, për dënimin e organizatorëve dhe/ose pjesëmarrësve në një tubim paqësor me gjobë ose burgim gjer në një vit është joproporcional, në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8773/2001. Edhe pse në rastin e parashikimit të nenit 262, paragrafi i parë, nuk ndodhemi përpara ndonjë interesi publik të cenuar, masa e dënimit që parashikohet në të është më e rëndë sesa masat e dënimit të parashikuara nga ligji nr. 8773/2001.

<sup>18</sup> Raporti i Përgjithshëm i 25-të mbi aktivitetet e KPT-së (CPT/Inf (2016) 10), paragrafi 84.

<sup>19</sup> *Muršić kundër Kroacisë* [GC], nr. 7334/13, 20 tetor 2016.



Më të drejtë, Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se: “GJEDNJ-ja ka pranuar se e drejta e tubimit paqësor e garantuar nga neni 11 i KEDNJ-së është themelore në një shoqëri demokratike, e, për rrjedhojë, nuk duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtuar (shih Kudrevičius dhe të tjerë kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, § 91). Kjo e drejtë mbulon si mbledhjet private, ashtu edhe mbledhjet në vende publike, qofshin të palëvizshme ose në formë procesioni. E drejta e tubimit ushtrohet si nga pjesëmarrësit individualë, ashtu edhe nga personat që e organizojnë atë (shih Djavit An kundër Turqisë, 20 shkurt 2003, § 56).

Gjykata, në jurisprudencën e saj, i ka kushtuar rëndësi lirisë së tubimit, duke vlerësuar se ajo është e lidhur ngushtë edhe me lirinë e shprehjes, pasi mbrojtja e mendimeve dhe liria e shprehjes së tyre është një nga objektivat e lirisë së tubimit dhe organizimit (shih vendimin nr.11, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Nga ana tjetër, neni 47, pika 2, i Kushtetutës parashikon se “tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”. Në këtë mënyrë Kushtetuta ia ka deleguar ligjvënësit rregullimin e procedurave që duhet të ndiqen kur tubimet paqësore zhvillohen në sheshe dhe në vende të kalimit publik, pasi në këto lloj rastesh ushtrimi i lirisë së tubimit paqësor ndikon në ushtrimin e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të tjerë, të garantuar nga neni 38 i Kushtetutës.

Në praktikën e saj GJEDNJ-ja ka pranuar se e liria e tubimit paqësor nuk është absolute, por mund të jetë objekt i kufizimeve në përputhje me paragrafin 2 të nenit 11 të Konventës. Një ndërhyrje në ushtrimin e kësaj të drejte nuk ka nevojë të përbëjë një ndalim të plotë, ligjor ose de facto, por mund të konsistojë në masa të ndryshme të tjera të marra nga autoritetet (Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, §§ 91 dhe 100).

Sipas Komisionit të Venecias, legjislacioni kombëtar që rregullon lirinë e tubimit duhet të artikulojë në mënyrë të qartë parimet kryesore:

- (i) prezumimi në favor të mbajtjes së tubimeve, i cili është parim qendror në gëzimin e lirisë së tubimit dhe si pasojë e të cilit, autoritetet ligjvënëse kanë në dispozicion “një spektër të gjerë” kufizimesh të mundshme që nuk ndërhyjnë në thelbin e së drejtës;
- (ii) detyra e shtetit për të mbrojtur tubimet paqësore në kuptimin që është përgjegjësia kryesore e shtetit të vendosë mekanizma dhe procedura të përshtatshme për të siguruar që liria e tubimit, praktikisht, të gëzohet dhe të mos u nënshtrohet rregullave të tepruara burokratike. Shteti ka detyrim pozitiv të mbrojë aktivisht tubimet paqësore dhe të ligjshme. Mund të kërkohet të ndërhyhet për të siguruar kushte që lejojnë ushtrimin e lirisë së tubimit dhe kjo mund të kërkojë marrjen e masave pozitive për të mundësuar që tubimet e ligjshme të vazhdojnë në mënyrë paqësore;
- (iii) proporcionaliteti, si një nga kriteret kryesore që duhet të drejtojnë shtetin kur vendos kufizime. Proporcionaliteti kërkon që shteti të miratojë mjetet më pak ndërhyrëse për arritjen e objektivave të përcaktuara. Kjo përfshin arritjen e një ekuilibri të drejtë midis interesave të atyre që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e tubimit dhe interesave të përgjithshme të pjesës tjetër të komunitetit (shih Opinionin e Komisionit të Venecias për lirinë e tubimit (CDL-PI (2014)0003, 1 korrik 2014, faqet 12-15).

Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias ka pohuar se kryerja e njoftimit paraprak nuk cenon lirinë e tubimit paqësor, sepse ky lloj njoftimi i mundëson shtetit të garantojë më mirë natyrën paqësore të një tubimi dhe të marrë masa për të lehtësuar tubimin ose për

*të mbrojtur rendin publik, sigurinë publike dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve (shih Opinionin e Komisionit të Venecias mbi udhërrëfyesin e lirisë së tubimeve paqësore, CDL-AD(2019)017, 8 korrik 2019, § 25, faqe 10).*

*Neni 262 është një normë penale, pjesë e korpusit të dispozitave ligjore të përfshira në KP, e cila prek të drejtat e njeriut, pasi parashikon dënim penal në rastet e mosrespektimit të saj. Legjislacioni penal është tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër (shih vendimin nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Duke pasur parasysh rëndësinë që ka legjislacioni penal dhe sidomos efektin e dënimeve penale mbi të drejtat e njeriut, Gjykata çmon se normat penale duhet të jenë të parashikueshme dhe të qarta, ose thënë ndryshe, duhet të respektojnë parimin e sigurisë juridike.”*

Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se togfjalëshi “*pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta*”, në paragrafin e parë të nenit 262 të KP-së, është i papajtueshëm me nenin 47 të Kushtetutës, është i bazuar dhe ka vendosur pranimin e kërkesës, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit të plotësojë normën ligjore nga data e shpalljes së vendimit të GjK deri në hyrjen në fuqi të tij.

Për gjithë sa parashtroam më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike*”, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”:

### **REKOMANDOJMË:**

- Aplikimin e masave të sigurimit personal “arrest në burg” si masë e fundit dhe përjashtimore për personat nën hetim për kryerjen e veprave penale që parashikojnë dënime të rënda.
- Marrjen e masave për analizimin e këtij rasti nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe nxjerrjen e akteve të nevojshme për unifikuar praktikën e organeve gjyqësore sa i përket një qëndrimi më korrekt në vlerësimin e kërkesave të prokurorisë për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe vendosjes së masave të sigurimit personal ndaj shtetasve në hetim, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.
- Marrjen e masave për analizimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndryshimin e praktikës së caktimit të masave të “arrestit në burg” për personat nën hetim me qëllim dhënien e kohës së nevojshme akuzës për të kryer veprimet hetimore, pasi bie në kundërshtim me kriteret/arsyet për të cilat jepen masat e sigurisë.
- Marrjen e masave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndryshimin e praktikës të atribuimit në bllok të veprave penale për personat nën hetim si dhe

ndalimin e gjykimeve në bllok të personave të arrestuar/ndaluar, si një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut.

- Marrjen e masave për zbatimin korrekt në frymë dhe gërmë të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur gjatë procedurës së vleftësimit të masave të sigurimit për fëmijët.
- Marrjen e masave nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë nga prokuroritë e rretheve me institucionin e Avokatit të Popullit, duke shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e materialeve dhe dokumenteve hetimore.
- Marrjen e masave nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për hartimin e një udhëzimi për drejtimin e punës së prokurorëve dhe opgj-ve në prokurori, për argumentimin e kërkesës për vlerësimin e arresit në flagrancë apo të ndalimit, si dhe për caktimin e masës së sigurimit që vlerësohet e përshtatshme, duke zbatuar me korrektesë dispozitat e parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim respektimin e të drejtave të shtetasve.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**